



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 72/17 prot.

Datë 20.04.2026

V E N D I M
Nr. 516/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “Rej” SHPK, me NIPT J93711608Q, dhe adresë Rruga Dritan Hoxha, Ngjitur me Shkollen Ahmet Gashi, Kulla Jeshile, Nr.Pasuri 8/374 /ND+3-6, H, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlora limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.09.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 13.10.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 16.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Rej	19,482,000	lekë	Skualifikuar
Asi Invest	21,510,000	lekë	Kualifikuar
Alb Garden	22,278,000	lekë	Kualifikuar
Cara	25,500,000	lekë	Skualifikuar
BOE Agro - Korani shpk & Kurora	25,608,000	lekë	Kualifikuar
Gjelbërimi 2000	26,252,850	lekë	Skualifikuar
Pastrime Silvio	30,634,500	lekë	Kualifikuar
Clean Fast	30,785,382	lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 23.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 31.10.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6027 si dhe nr. Protokoli 3099/2025 datë 31.10.2025 i operatorit ekonomik “AlbGarden” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Asi Invest” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit

II.5.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3099/1 prot., datë 03.11.2025.

II.6. Në datën 31.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6030 dhe nr.3102/2025 prot, datë 31.10.2025 i operatorit ekonomik “Rej” SHPK, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK , nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b)

të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3102/1 prot, datë 03.11.2025.

II.7. Në datë 11.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1837/2025, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Asi Invest” SHPK, duke e skualifikuar atë në zbatim të vendimit të KSHA nr.129/2025, datë 11.11.2025.*
3. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
4. *Autoriteti kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
5. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
6. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK dhe operatori ekonomik “Rej” SHPK.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.8. Me shkresën nr. 2811/4/1 prot., datë 16.12.2025, protokolluar me tonën nr. 3099/9 prot, datë 18.12.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 1837/2025, datë 11.12.2025 të KPP, duke skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “Asi Invest” SHPK, si dhe duke rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “REJ” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.9. Nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe nga informacioni i autoritetit kontraktor rezultoi se në datën 16.12.2025, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Rej” SHPK dhe “Asi Invest” në zbatim të vendimit Nr. 1837/2025, datë 11.12.2025 të KPP, përkatësisht:

Rej	19,482,000	lekë	Skualifikuar
Asi Invest	21,510,000	lekë	Skualifikuar
Alb Garden	22,278,000	lekë	Kualifikuar
Cara	25,500,000	lekë	Skualifikuar
BOE Agro - Korani shpk & Kurora	25,608,000	lekë	Kualifikuar
Gjelbërimi 2000	26,252,850	lekë	Skualifikuar
Pastrime Silvio	30,634,500	lekë	Kualifikuar
Clean Fast	30,785,382	lekë	Skualifikuar

II.10. Në datë 29.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1920/2025, ku vendosi:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.11. Në datën 09.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.12. Në datën 11.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6245 dhe nr.72/2026 prot, datë 12.01.2026 i operatorit ekonomik “Rej” SHPK, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK , nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.13 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.72/1 prot, datë 12.01.2026.

II.14.Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datën 16.01.2026 operatori ekonomik “Albgarden” SHPK ka paraqitur argumenta, të cilat janë protokolluar me tonën me nr.72/2 prot., datë 19.01.2026.

II.15.Në datën 19.01.2026, autoritetit kontraktor nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike ka përcjelle pranë KPP vendimin e KSHA nr.06/2026, datë 19.01.2026, protokolluar me tonën me

nr72/3 prot., datë 19.01.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ‘Rej’ SHPK. Referuar vendimit të KSHSA rezulton se ky i fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.16. Vendimin e KSHA nr.06/2026, datë 19.01.2026, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr.72/4 prot., datë 21.01.2026.

II.17. Me shkresën nr. 72/5 prot., datë 12.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua Autoritetit Rrugor Shqiptar (Drejtorisë së Rajonit Qendër Lindje Korçë), duke i kërkuar informacionin si më poshtë:

[...] Operatori ekonomik “Rej” SHPK më datë 22.02.2024 ka lidhur kontratën me objekt “Mirëmbajtje me performancë K/Zemblak-Liqenas-Dog.Goricë, Libonik-Rrëmbec-Plasë” me institucionin tuaj. Operatori ekonomik i sipërcituar ka paraqitur në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, në funksion të shërbimeve të mëparshme të ngjashme, situacione dhe fatura tatimore të shitjes ku në cilësinë e blerësit është institucioni juaj.

*Në kushtet kur në këto fatura dhe situacione nuk evidentohet vlera në lekë për secilin prej zërave pjesë e situacioneve, KPP vlerëson të kërkojë nga ana juaj vlerën në lekë (pa tvsh) për zërin nr.4 “**Pastrim i vegjetacionit**” në situacionet dhe faturat e poshtëshënuara:*

- 1. Fatura nr.40/2024, datë 12.03.2024, shoqëruar me situacionin nr.01;*
- 2. Fatura nr.45/2024, datë 28.03.2024, shoqëruar me situacionin nr.02;*
- 3. Fatura nr.58/2024, datë 25.04.2024, shoqëruar me situacionin nr.03;*
- 4. Fatura nr.83/2024, datë 04.06.2024, shoqëruar me situacionin nr.04;*
- 5. Fatura nr.95/2024, datë 08.07.2024, shoqëruar me situacionin nr.05;*
- 6. Fatura nr.116/2024, datë 29.08.2024, shoqëruar me situacionin nr.06;*
- 7. Fatura nr.134/2024, datë 07.10.2024, shoqëruar me situacionin nr.07;*
- 8. Fatura nr.141/2024, datë 23.10.2024, shoqëruar me situacionin nr.08;*
- 9. Fatura nr.163/2024, datë 25.11.2024, shoqëruar me situacionin nr.09;*
- 10. Fatura nr.175/2024, datë 1.12.2024, shoqëruar me situacionin nr.10;*
- 11. Fatura nr.184/2024, datë 27.12.2024, shoqëruar me situacionin nr.11;*
- 12. Fatura nr.19/2025, datë 18.02.2025, shoqëruar me situacionin nr.12;*
- 13. Fatura nr.36/2025, datë 02.04.2025, shoqëruar me situacionin nr.13*

II.18. Me shkresën nr. 72/6 prot., datë 12.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua Autoritetit Rrugor Shqiptar (Drejtorisë së Rajonit Qendër Përendim Tiranë), duke i kërkuar informacionin si më poshtë:

[...]Operatori ekonomik “Rej” SHPK më datë 07.01.2022 ka lidhur kontratën me objekt “Mirëmbajtje me performancë K/Zemblak-Liqenas-Dog.Goricë, Libonik-Rrëmbec-Plasë” me institucionin tuaj. Operatori ekonomik i sipërcituar ka paraqitur në procedurën e

prokurimit objekt shqyrtimi, në funksion të shërbimeve të mëparshme të ngjashme, situacione dhe fatura tatimore të shitjes ku në cilësinë e blerësit është institucioni juaj.

*Në kushtet kur në këto fatura dhe situacione nuk evidentohet vlera në lekë për secilin prej zërave pjesë e situacioneve, KPP vlerëson të kërkojë nga ana juaj vlerën në lekë (pa tvsh) për zërin nr.4 "**Pastrim i vegjetacionit**" në situacionet dhe faturat e poshtëshënuara:*

- 1. Fatura nr.251/2022, datë 09.11.2022, shoqëruar me situacionin nr.10;*
- 2. Fatura nr.267/2022, datë 12.12.2022, shoqëruar me situacionin nr.11;*
- 3. Fatura nr.284/2023, datë 17.01.2023, shoqëruar me situacionin nr.12;*
- 4. Fatura nr.10/2023, datë 13.02.2023, shoqëruar me situacionin nr.13;*
- 5. Fatura nr.24/2023, datë 13.03.2023, shoqëruar me situacionin nr.14;*
- 6. Fatura nr.49/2023, datë 11.05.2023, shoqëruar me situacionin nr.15;*
- 7. Fatura nr.50/2023, datë 11.05.2023, shoqëruar me situacionin nr.16;*
- 8. Fatura nr.64/2023, datë 14.06.2023, shoqëruar me situacionin nr.17;*
- 9. Fatura nr.78/2023, datë 24.07.2023, shoqëruar me situacionin nr.18;*
- 10. Fatura nr.88/2023, datë 17.08.2023, shoqëruar me situacionin nr.19;*
- 11. Fatura nr.98/2023, datë 18.09.2023, shoqëruar me situacionin nr.20;*
- 12. Fatura nr.115/2023, datë 28.10.2023, shoqëruar me situacionin nr.21;*
- 13. Fatura nr.124/2023, datë 15.11.2023, shoqëruar me situacionin nr.22;*
- 14. Fatura nr.135/2023, datë 18.12.2023, shoqëruar me situacionin nr.23;*
- 15. Fatura nr.145/2023, datë 31.12.2023;*
- 16. Fatura nr.69/2024, datë 10.05.2024*

II.19. Me shkresën nr.72/7 prot., datë 12.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ka vënë në dijeni palët se për shkaqe të nevojshme për verifikim, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.20. Me shkresën nr.113 prot., datë 18.02.2026 me objekt "*Kthim përgjigje, Informacion*", protokolluar me tonën me nr.72/8 prot., datë 20.02.2026, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Rajonit Qendër Lindje Korçë ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me kërkesën e bërë si më poshtë vijon:

Në përgjigje të kërkesës Tuaj, Nr.72/5 prot. Datë 12.02.2026 me lëndë:"Kërkesë për informacion", Ju informojmë se:

Drejtoria e Rajonit Qendër Lindje Korçë ka lidhur nje kontratë "Mirëmbajtje me performancë" K/Zëmlak-Liqenas-Gog. Goricë, Libonik-Rrëmbec-Plasë"44.3km,me Nr.9, datë 22.02.2024,me Operatorin Ekonomik "REJ"SHPK, me kohëzgjatje 08.01.2024-08.02.2025, bazuar kjo kontratë në Marrëveshjen Kuadër(Ku Të Gjitha Kushtet Janë Të Përcaktuara Për Shërbime) me Nr.632 prot, datë 20.01.2021, në të cilën është pasqyruar edhe oferta ekonomike e Operatorit Ekonomik "REJ"SHPK.

Drejtoria e Rajonit Qendër Lindje Korçë, ka Ofertën Ekonomike të Operatorit Ekonomik "REJ" SHPK., me Nr.4/2, datë 09.01.2024, në të cilën jepen çmimet për të gjithë zërat e punimeve që do kryente Operatori Ekonomik "REJ" SHPK, ku zëri nr.4, i kërkuar nga Ju, "Pastrim i vegjetacionit" ka çmimin lekë/km/muaj 4,371.00 (katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e një lekë, pa tvsh).

Zëri nr.4 "Pastrim i vegjetacionit" i paguar nga ana Jonë, është si më poshtë:

Nr.	Nr. Faturës, datë	Situacioni nr.	Çmimi (lekë/km/uaaj), pa tvsh	Pagesa mujore , lekë, pa tvsh
1.	Fatura nr.40/2024, datë 12.03.2024	01	4,371.00	193,635
2	Fatura nr.45/2024, datë 28.03.2024	02	4,371.00	192,542
3	Fatura nr.58/2024, datë 25.04.2024	03	4,371.00	193,635
4	Fatura nr.83/2024, datë 04.06.2024	14	4,371.00	192,761
5	Fatura nr.95/2024, datë 08.07.2024	05	4,371.00	192,674
6	Fatura nr.116/2024, datë 29.08.2024	06	4,371.00	192,564
7	Fatura nr.134/2024, datë 07.10.2024	07	4,371.00	192,586
8	Fatura nr.141/2024, datë 23.10.2024	08	4,371.00	192,477
9	Fatura nr.163/2024, datë 25.11.2024	09	4,371.00	192,280
10	Fatura nr.175/2024, datë 1.12.2024	10	4,371.00	192,542
11	Fatura nr.184/2024, datë 27.12.2024	11	4,371.00	192,411
12	Fatura nr.19/2025, datë 18.02.2025	12	4,371.00	192,980
13	Fatura nr.36/2025, datë 02.04.2025	13	4,371.00	192,542

II.21. Me shkresën nr.103/1 prot., datë 24.02.2026 me objekt "Dërgim informacioni", protokolluar me tonën me nr.72/9 prot., datë 27.02.2026, Autoriteti Rrugor Shqiptar (Drejtoria e Rajonit Qendër Perëndim Tiranë), ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me kërkesën e bërë si më poshtë vijon:

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 72/6 Prot, datë 12.02.2026 me lëndë: "Kërkesë për informacion", administruar nga D.R.Q.P. Tiranë me Nr. 103 Prot, datë 16.02.2026, në kudër të shqyrtimit të ankesës për kontratën me objekt: " Mirëmbajtje me performancë K/Zemblak - Ligenas - Dog. Goricë, Libonik-Rrëmbec - Plasë", ju informojmë si më poshtë:

Pas verifikimit të situacioneve dhe faturave përkatëse të administruara nga institucioni ynë, për punimet e kryera në objektin e sipërcituar, rezulton se vlera (pa tvsh) për zërin nr.4 'Pastrim vegjetacioni është si vijon:

Sit nr 10 193,307 lekë pa tvsh

<i>Sit nr 11</i>	<i>193,635</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 12</i>	<i>192,215</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 13</i>	<i>193,635</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 14</i>	<i>193,635</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 15</i>	<i>193,635</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 16</i>	<i>192,870</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 17</i>	<i>193,635</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 18</i>	<i>193,635</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 19</i>	<i>193,635</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 20</i>	<i>193,635</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 21</i>	<i>193,635</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 22</i>	<i>193,635</i>	<i>lekë pa tvsh</i>
<i>Sit nr 23</i>	<i>193,635</i>	<i>lekë pa tvsh</i>

Faturat me nr. 145/2023, datë 31.12.2023 dhe faturës me nr. 69/2024, datë 10.05.2024, i përkasin situacioneve me nr. 24 dhe nr. 25. Këto situacione janë kthyer pranë Mbikëqyrësit të punimeve për mosplotësim të punimeve të kryera konform kontratës së mirëmbajtjes dhe specifikimeve teknike.

II.22. Me shkresën nr. 72/10 prot., datë 03.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua Autoritetit Rrugor Shqiptar (Drejtorisë së Rajonit Qendër Përendim Tiranë), duke i kërkuar informacionin si më poshtë:

[...]

- 1. Fatura me nr.145/2023, datë 31.12.2023 dhe fatura me nr.69/2024, datë 10.05.2024, të kthyer pranë Mbikëqyrësit të punimeve për mosplotësim të punimeve të kryera konform kontratës së mirëmbajtjes dhe specifikimeve teknike, janë kthyer për zërin **Pastrim i vegjetacionit** ?!*
- 2. Nëse zëri **Pastrim i vegjetacionit** është pranuar nga mbikëqyrësi i punimeve, sa është vlera në lekë (pa tvsh) në këto dy fatura?*

*Gjithashtu kërkojmë nga ana juaj të evidentohet vlera në lekë (pa tvsh) për zërin nr.4 **“Pastrim i vegjetacionit”** në situacionin nr. 9 dhe faturën nr.236/2022, datë 13.10.2022 bashkëngjitur kësaj shkrese. [...].*

II.23. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.1209 prot., datë 11.03.2026, me objekt *“Kërkesë për përshpejtim të shqyrtimit dhe marrjen e vendimit përfundimtar mbi procedurat e prokurimit ‘kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT’*, protokolluar me tonën me nr.72/11 prot., datë 13.03.2026, i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik me kërkesë për vendimarrje lidhur me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.24. Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr.72/12 prot., datë 24.03.2026 me objekt “Kthim përgjigje”, informon autoritetin kontraktor si më poshtë: [...] sikurse jeni vënë në dijeni edhe me shkresën nr.72/7 prot., datë 12.02.2026 me objekt “Vënie në dijeni”, lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115, pika 5 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “5. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë. Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijeni palët”, ju bën të ditur, se për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e sipërcituar, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.25. Në kushtet kur Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Rajonit Qendër Përendim nuk ktheu përgjigje lidhur me kërkesën e bërë nga KPP me shkresën nr. 72/10 prot., datë 03.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua përsëri Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtorisë së Rajonit Qendër Përendim Tiranë me shkresën nr.72/13 prot., datë 24.03.2026 duke i rikërkuar të njëjtin informacion.

II.26. Me shkresën nr.103/4 prot., datë 07.04.2026.2026 me objekt “Dërgim informacioni”, protokolluar me tonën me nr.72/14 prot., datë 09.04.2026, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Rajonit Qendër Përendim Tiranë ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me kërkesën e bërë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur të saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit object ankimi me arsyen e mospërmbyshjes se kriterit 2.3.1 të dokumentave të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ndërsa në shtojcën 7 “Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objket ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për SUT, për 36 muaj”.

Tabela Nr. 1

Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia 12 muaj	Frekuenca per 36 muaj	Sasia 36 muaj
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	m2	9,000	1095	27,000
2	Kositje bari dhe largimi i tyre	m2	9,000	36	27,000
3	Vaditje e sipërfaqeve të gjelbërta	m2	9,000	369	27,000

4	Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)	m2	1,000	12	3,000
5	Mirëmbajtje pemesh dhe shkurresh	copë	900	36	2,700
6	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre	ml	180	15	540
7	Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve dekorative sezonale	m2	100	6	300
8	Furnizim vendosje stolash te rinj	copë	10	3	30
9	Mirëmbajtje stolash ne ambientet e jashtme	copë	20	3	60
10	Furnizim vendosje kosha duhani	copë	5	3	15

III.1.2.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se peratori ekonomik “Rej” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

1. Kontratë shërbimi datë 03.01.2024, lidhur mes “Rej Energy” SHPK, (porositësi) dhe “Rej” SHPK (kontraktori) me objekt “Kontratë shërbimi për punime mirëmbajtje rrugore për HEC Cemerica 1,2,3”.
 - Faturë tatimore nr.158/2024, datë 13.11.2024 lëshuar nga Rej shpk për Rej Energy shpk, me përshkrimin “Situacion mirëmbajtje rrugore në rrugët e HEC Cermenica 1, 2, 3”, me vlerë totale 67.724.000 lekë pa tvsh.
 - Formular vlerësimi lëshuar nga “Rej Energy” SHPK për përmbushjem me sukses të kontratës nga “Rej”SHPK.
2. Kontratë shërbimi Nr.632 prot., datë 20.01.2021, marrëveshje kuadër me afat 48 muaj, lidhur mes Autoritetit Rrugor Shqiptar me objekt dhe Rej shpk me objekt “Mirëmbajtje me performancë K/Zëmlak – Liqenas – Dog. Goricë, Libonicë-Rrëmbec-Plasë”, Loti 9.
 - Kontratë shërbimi nr. 20, datë 28.01.2021 mes Drejtorisë së Rajonit Qendror Tiranë (Autoritetit Rrugor Shqiptar) dhe Rej shpk me objekt “Mirëmbajtje me performancë K/Zëmlak – Liqenas – Dog. Goricë, Libonicë-Rrëmbec-Palasë”, me vlerë 23,642,821 lekë pa tvsh, bashkëlidhur situacionet dhe faturat tatimore për këto situacione për periudhën Janar 2021-Dhjetor 2021.
 - Kontratë shërbimi nr. 9, datë 07.01.2022 mes Drejtorisë së Rajonit Qendror Tiranë (Autoritetit Rrugor Shqiptar) dhe Rej shpk me objekt “Mirëmbajtje me performancë K/Zëmlak – Liqenas – Dog. Goricë, Libonicë-Rrëmbec-Palasë”, me vlerë 72,283,156.77 lekë me tvsh, bashkëlidhur situacionet dhe faturat tatimore për këto situacione për periudhën 07.01.2022-.7.01.2024. (24 muaj).
 - Kontratë shërbimi nr. 9, datë 22.02.2024 mes Drejtorisë së Rajonit Qendër Lindje Korcë (Autoritetit Rrugor Shqiptar) dhe Rej shpk me objekt “Mirëmbajtje me performancë K/Zëmlak – Liqenas – Dog. Goricë, Libonicë-Rrëmbec-Palasë”, me vlerë 40,201,956 lekë me tvsh, bashkëlidhur situacionet dhe faturat tatimore për këto situacione për periudhën 22.02.2024-02.04.2025

3. Kontratë punë publike nr. 3688/16 prot., datë 14.11.2022 mes Bashkisë Pogradec dhe Rej SHPK, me objekt: Rikonstruksion dhe shtesë shkolla e mesme “14 Engjejt” dhe 9 vjecare “Servet Agolli” Bucimas”, me vlerë totale 116.247.736 lekë pa tvsh , bashkëlidhur faturat tatimore për punën e kryer, situacioni përfundimtar.
4. Kontratë punë publike nr. 578/18 prot., datë 22.12.2023 mes Bashkisë Pogradec dhe Rej SHPK, me objekt: Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore”, me vlerë totale 70,743,198 lekë pa tvsh , bashkëlidhur faturat tatimore për punën e kryer, situacioni përfundimtar.
5. Kontratë shërbimi Nr.2295/3 prot., datë 30.07.2020, me object “*Pastrim, Grumbullim,dhe largim i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësisive administrative*”, lidhur mes Bashkisë Pogradec dhe operatorit ekonomik "Rej" SHPK, marrëveshje kuadër me afat pesë vjecar, shoqëruar me vërtetim realizimi për periudhën 01.08.2020-31.12.2020, situacione mujore dhe faturat respective për këto situacione.
 - Situacione mujore për periushën Janar-Dhjetor 2021 dhe faturat respective për këto situacione për kontratën e shërbimit Nr.2295/3 prot., datë 30.07.2020, me object ‘*Pastrim, grumbullim...*’.
 - Situacione mujore për periushën Janar-Dhjetor 2022 dhe faturat respective për këto situacione për kontratën e shërbimit Nr.2295/3 prot., datë 30.07.2020, me object ‘*Pastrim, grumbullim...*’.
 - Situacione mujore për periushën Janar-Dhjetor 2023 dhe faturat respective për këto situacione për kontratën e shërbimit Nr.2295/3 prot., datë 30.07.2020, me object ‘*Pastrim, grumbullim...*’.
 - Vërtetim nr.2254/1 prot., datë 17.05.2024 lëshuar nga Bashkia Pogradec, për realizimin me sukses të kontratës me object “*Pastrim grumbullim dhe largim i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësisive administrative*” nga Rej” SHPK për periudhën 01.01.2022 – 30.04.2024, shoqëruar me situacione mujore dhe faturat respective për këto situacione.
 - Vërtetim nr.1048/1 prot., datë 28.04.2025 lëshuar nga Bashkia Pogradec, për realizimin me sukses të kontratës me object “*Pastrim grumbullim dhe largim i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësisive administrative*” nga Rej” SHPK për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, shoqëruar me situacione mujore dhe faturat respective për këto situacione.
 - Vërtetim nr.1048/3 prot., datë 08.08.2025 lëshuar nga Bashkia Pogradec, për realizimin me sukses të kontratës me object “*Pastrim grumbullim dhe largim i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësisive administrative*” nga Rej” SHPK për periudhën 01.01.2025 – 31.05.2025, shoqëruar me situacione mujore dhe faturat respective për këto situacione.

III.1.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

- *Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

III.1.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, në pikën 2 dhe 3, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 2. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

3. *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor

përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat e shërbimeve, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë parashikimet e përcaktuara në nenin 41, pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe për të gjykuar në lidhje me përmbushjen apo jo nga ana e operatorit ekonomik ‘Rej’ SHPK të kriterit më sipër lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, KPP do ti qëndrojë strikt këtij rregullimi. Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të dokumenteve standarde të tenderit, për përvojë të ngjashme të kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.1.2. të këtij vendimi

Nga shqyrtimi i i dokumentacionit të ngarkuar në sistem nga operatori ekonomik “Rej” SHPK për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme të kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ankimuesi, porë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin e hartuar nga autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 3 vjecar nga data publikimit të njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra shërbime të mëparshme të ngjashme ku vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë *jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*) si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga ankimuesi

me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre).

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave të shërbimeve, ligjvënësi në nenin 41, pika 3 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, mënyrën se si ky kriter përmbushet në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin publik apo me sektorin privat. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, afati i kërkimit të dokumentacioni është brenda periudhës 3 vjeçare si dhe vlera e kërkuar është brenda kufijve të vlerës sikundër parashikohet edhe në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në këtë kuadër siç është cituar më sipër në këtë vendim, KPP do ti gjëndrojë strikt këtij rregullimi dhe kriterit të vecantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit për të vlerësuar nëse ankimuesi e përmbush këtë kriter apo jo.

KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të dorëzuara nga ankimuesi për përmbushjen e kriterit për përvojën e mëparshme të ngjashme, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit, përshkrimi i shërbimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha dokumentet e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim këto kontrata:

1.Kontratë shërbimi datë 03.01.2024, lidhur mes “Rej Energy” SHPK, (porositësi) dhe “Rej” SHPK (kontraktori) me objekt “*Kontratë shërbimi për punime mirëmbajtje rrugore për HEC Cemerica 1,2,3*”.

- Faturë tatimore nr.158/2024, datë 13.11.2024 lëshuar nga Rej shpk për Rej Energy shpk, me përshkrimin “*Situacion mirëmbajtje rrugore në rrugët e AKS HEC Cermenica 1, 2, 3*”, me vlerë totale 67.724.000 lekë pa tvsh.
- Formular vlerësimi lëshuar nga “Rej Energy” SHPK për përmbushjem me sukses të kontratës nga “Rej” SHPK.

2.Kontratë shërbimi nr. 9, datë 07.01.2022 mes Drejtorisë së Rajonit Qendror Tiranë (Autoritetit Rrugor Shqiptar) dhe Rej shpk me objekt “*Mirëmbajtje me performancë K/Zëmbiak – Liqenas – Dog. Goricë, Libonicë-Rrëmbec-Palasë*”, me vlerë 72,283,156.77 lekë me tvsh, bashkëlidhur situacionet dhe faturat tatimore për këto situacione për periudhën 07.01.2022-07.01.2024. (24 muaj).

3.Kontratë shërbimi nr. 9, datë 22.02.2024 mes Drejtorisë së Rajonit Qendër Lindje Korcë (Autoritetit Rrugor Shqiptar) dhe Rej shpk me objekt “*Mirëmbajtje me performancë K/Zëmbiak – Liqenas – Dog. Goricë, Libonicë-Rrëmbec-Palasë*”, me vlerë 40,201,956 lekë me tvsh, bashkëlidhur situacionet dhe faturat tatimore për këto situacione për periudhën 22.02.2024-02.04.2025

4.Situacione mujore për periudhën Janar-Dhjetor 2023 dhe faturat respective për këto situacione për kontratën e shërbimit Nr.2295/3 prot., datë 30.07.2020, me objekt *‘Pastrim, grumbullim...’*.

5.Vërtetim nr.2254/1 prot., datë 17.05.2024 lëshuar nga Bashkia Pogradec, për realizimin me sukses të kontratës me objekt *“Pastrim grumbullim dhe largim i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësive administrative”* nga Rej” SHPK për periudhën 01.01.2022 – 30.04.2024, shoqëruar me situacione mujore dhe faturat respective për këto situacione.

6.Vërtetim nr.1048/1 prot., datë 28.04.2025 lëshuar nga Bashkia Pogradec, për realizimin me sukses të kontratës me objekt *“Pastrim grumbullim dhe largim i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësive administrative”* nga Rej” SHPK për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, shoqëruar me situacione mujore dhe faturat respective për këto situacione.

7.Vërtetim nr.1048/3 prot., datë 08.08.2025 lëshuar nga Bashkia Pogradec, për realizimin me sukses të kontratës me objekt *“Pastrim grumbullim dhe largim i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësive administrative”* nga Rej” SHPK për periudhën 01.01.2025 – 31.05.2025, shoqëruar me situacione mujore dhe faturat respective për këto situacione

Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel dokumentet e sipërcituara, pasi ato i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (për ato fatura ose zëra të tyre që janë brenda afatit tre vjecar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës) si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni i Prokurimit Publik, pasi veçoi dokumentacionin e sipërcituar, i cili i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren se, nga përllogaritja e kontratave, situacioneve dhe faturat e paraqitura nga ankimuesi ‘Rej’ SHPK, rezulton se janë në vlerën 16,999,969 lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet që operatori ekonomik të dëshmojë realizimin shërbimeve të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit, pra kemi $40\% * 32,115,167.55$ lekë pa TVSH = 12,846,067 lekë pa TVSH. Për të dëshmuar shërbimet e mëparshme të ngjishme ankimuesi duhet të paraqiste dëshmi që vertetonin shërbimet e kryera në një vlerë jo më të vogël se 12,846,067 lekë pa TVSH. Siç vihet re me vlerën e shërbimeve prej që 16,999,969 lekë pa TVSH, të cilat KPP i konsideron si shërbime të ngjashme, ankuesi ‘Rej’ SHPK e tejkalon vlerën e kërkuar nga kriteri i sipërcituar e cila duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet apo e shprehur në vlerë jo më e vogël se 12,846,067 lekë pa TVSH. Më konkretisht shpjegimi i sipërcituar do të paraqitet në formë tabelare si më poshtë :

	REJ				
Nr ren dor	Shërbime të ngjashme	Vlera pa TVSH	Emërtimi zërit të shërbimeve të ngjashme	Vlera pa tvsh e zerit te shërbimeve të ngjashme	
1	Kontratë shërbimi datë 03.01.2024, lidhur mes “Rej Energy” SHPK, (porositësi) dhe “Rej” SHPK (kontraktori) me object “Kontratë shërbimi për punime mirëmbajtje rrugore për HEC Cemerica 1,2,3” me vlerë 67.724.000 lekë pa tvsh.+ situacion punimesh	67.724.000			
	Faturë tatimore nr.158/2024, datë 13.11.2024, “REJ” SHPK	67.724.000	Pastrim vegjetacioni	7,000,000	
2	Kontratë shërbimi nr. 9, datë 07.01.2022 mes Drejtorisë së Rajonit Qendror Tiranë (Autoritetit Rrugor Shqiptar) dhe Rej shpk me objekt “Mirëmbajtje me performancë K/Zëmlak – Liqenas – Dog. Goricë, Libonicë-Rrëmbec-Palasë”, me vlerë 72,283,156.77 lekë me tvsh, bashkëlidhur situacionet dhe faturat tatimore për këto situacione për periudhën 07.01.2022-.7.01.2024. (24 muaj).	72,283,156.77			Faturat tatimore për situacionet nga nr.1 deri në situacionin nr. 8 janë jashtë afatit tre vjeçar e për rrjedhojë nuk do të përlllogariten. Po ashtu faturat tatimore Fatura me nr.145/2023, datë 31.12.2023 (situacion 24) dhe fatura me nr.69/2024, datë 10.05.2024 (situacion 25) nuk do të përlllogariten pasi janë kthyer nga mbiqyrësi (referuar përgjigjes së dhënë me shkresën nr.103/1 prot., datë 24.02.2026 nga AK perfituese)

<i>Fatura nr.236/2022, datë 13.10.2022 + situacion nr.9</i>			193,635		
<i>Fatura nr.251/2022, datë 09.11.2022+ situacion nr.10</i>			193,635		
<i>Fatura nr.267/2022, datë 12.12.2022+ situacion nr.11</i>			193,635		
<i>Fatura nr.284/2023, datë 17.01.2023+ situacion nr.12</i>			192,215		
<i>Fatura nr.10/2023, datë 13.02.2023+ situacion nr.13</i>			193,635		
<i>Fatura nr.24/2023, datë 13.03.2023+ situacion nr.14</i>			193,635		
<i>Fatura nr.49/2023, datë 11.05.2023+ situacion nr.15</i>			193,635		
<i>Fatura nr.50/2023, datë 11.05.2023+ situacion nr.16</i>		Pastrim vegjetacioni	192,870		
<i>Fatura nr.64/2023, datë 14.06.2023+ situacion nr.17</i>			193,635		
<i>Fatura nr.78/2023, datë 24.07.2023+ situacion nr.18</i>			193,635		
<i>Fatura nr.88/2023, datë 17.08.2023+ situacion nr.19</i>			193,635		
<i>Fatura nr.98/2023, datë 18.09.2023+ situacion nr.20</i>			193,635		
<i>Fatura nr.115/2023, datë 28.10.2023+ situacion nr.21</i>			193,635		
<i>Fatura nr.124/2023, datë 15.11.2023+ situacion nr.22</i>			193,635		
<i>Fatura nr.135/2023, datë 18.12.2023+ situacion nr.23</i>			193,635		

3	Kontratë shërbimi nr. 9, datë 22.02.2024 mes Drejtorisë së Rajonit Qendër Lindje Korçë (Autoritetit Rrugor Shqiptar) dhe Rej shpk me objekt “Mirëmbajtje me performancë K/Zëmlak – Liqenas – Dog. Goricë, Libonicë-Rrëmbec-Palasë”, me vlerë 40,201,956 lekë me tvsh, bashkëlidhur situacionet dhe faturat tatimore për këto situacione për periudhën 22.02.2024-02.04.2025			
	<i>Fatura nr.40/2024, datë 12.03.2024 + situacion nr.1</i>		193,635	
	<i>Fatura nr.45/2024, datë 28.03.2024+ situacion nr.2</i>		192,542	
	<i>Fatura nr.58/2024, datë 25.04.2024+ situacion nr.3</i>		193,635	
	<i>Fatura nr.83/2024, datë 04.06.2024+ situacion nr.4</i>		192,761	
	<i>Fatura nr.95/2024, datë 08.07.2024+ situacion nr.5</i>		192,674	
	<i>Fatura nr.116/2024, datë 29.08.2024+ situacion nr.6</i>		192,564	
	<i>Fatura nr.134/2024, datë 07.10.2024+ situacion nr.7</i>		192,586	
	<i>Fatura nr.141/2024, datë 23.10.2024+ situacion nr.8</i>		192,477	
	<i>Fatura nr.163/2024, datë 25.11.2024+ situacion nr.9</i>		192,280	
	<i>Fatura nr.175/2024, datë 1.12.2024+ situacion nr.10</i>		192,542	
	<i>Fatura nr.184/2024, datë 27.12.2024+ situacion nr.11</i>		192,411	
	<i>Fatura nr.19/2025, datë 18.02.2025+ situacion nr.12</i>		192,980	

	<i>Fatura nr.36/2025, datë 02.04.2025+ situacion nr.13</i>		192,542	
4	Kontratë shërbimi Nr.2295/3 prot., datë 30.07.2020, me object “Pastrim, Grumbullim,dhe largim i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësisve administrative”, lidhur mes Bashkisë Pogradec dhe operatorit ekonomik "Rej" SHPK, marrëveshje kuadër me afat pesë vjecar, shoqëruar me vërtetim realizimi për periudhën 01.08.2020-31.12.2020, situacione mujore dhe faturat respective për këto situacione.			<i>Faturat e lëshuara për këto peridha nuk do të përlloriten pasi janë jashtë afatit tre vjecar.</i>
	Situacione mujore për periudhën Janar-Dhjetor 2021 dhe faturat respective për këto situacione për kontratën e shërbimit Nr.2295/3 prot., datë 30.07.2020, me object ‘Pastrim, grumbullim...’.			
	Situacione mujore për periudhën Janar-Dhjetor 2022 dhe faturat respective për këto situacione për kontratën e shërbimit Nr.2295/3 prot., datë 30.07.2020, me object ‘Pastrim, grumbullim...’.			

Vërtetim nr.2254/1 prot., datë 17.05.2024 lëshuar nga Bashkia Pogradec, për realizimin me sukses të kontratës me object “Pastrim grumbullim dhe largim i mbeturuinave të qytetit Pogradec dhe njërive administrative” nga Rej” SHPK për periudhën 01.01.2022 – 30.04.2024, shoqëruar me situacione mujore dhe faturat respective për këto situacione.				
Fatura nr.13/2023, datë 16.02.2023+ situacion nr.1(qyteti Pogradec)			409,500	
Fatura nr.30/2023, datë 20.03.2023+ situacion nr.2(qyteti Pogradec)			362,250	
Fatura nr.41/2023, datë 11.04.2023+ situacion nr.3(qyteti Pogradec)			409,500	
Fatura nr.51/2023, datë 11.05.2023+ situacion nr.4(qyteti Pogradec)		Pastrim plazhi nga mbeturinat+Plug im dhe	393,750	
Fatura nr.63/2023, datë 13.06.2023+ situacion nr.5(qyteti Pogradec)		lesim+pastrim bregu i liqinet nga algat me me	409,500	
Fatura nr.70/2023, datë 05.07.2023+ situacion nr.6(qyteti Pogradec)		mjet special të posacëm i pajisur me	393,750	
Fatura nr.84/2023, datë 08.08.2023+ situacion nr.7(qyteti Pogradec)		traktor tërheqës	409,500	
Fatura nr.92/2023, datë 08.09.2023+ situacion nr.8(qyteti Pogradec)			409,500	
Fatura nr.109/2023, datë 12.10.2023+ situacion nr.9(qyteti Pogradec)			393,750	

<i>Fatura nr.125/2023, datë 17.11..2023+ situacion nr.10(qyteti Pogradec)</i>		409,500	
<i>Fatura nr.137/2023, datë 21.12.2023+ situacion nr.11(qyteti Pogradec)</i>		393,750	
<i>Fatura nr.155/2024 datë 09.01.2024+ situacion nr.12(qyteti Pogradec)</i>		409,500	
Vërtetim nr.1048/1 prot., datë 28.04.2025 lëshuar nga Bashkia Pogradec, për realizimin me sukses të kontratës me object “Pastrim grumbullim dhe largim i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njërive administrative” nga Rej” SHPK për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, shoqëruar me situacione mujore dhe faturat respective për këto situacione			
<i>Fatura nr.15/2024, datë 12.02.2024+ situacion nr.1(qyteti Pogradec)</i>		409,500	
<i>Fatura nr.36/2024, datë 11.03.2024+ situacion nr.2(qyteti Pogradec)</i>	Pastrim plazhi nga mbeturinat+Plug im dhe lesim+pastrim bregu i liqinet nga algat me me mjet special të posacëm i pajisur me traktor tërheqës	378,000	
<i>Fatura nr.50/2024, datë 09.04.2024+ situacion nr.3(qyteti Pogradec)</i>		409,500	
<i>Fatura nr.70/2024, datë 13.05.2024+ situacion nr.4(qyteti Pogradec)</i>		393,750	
<i>Fatura nr.91/2024, datë 02.07.2024+ situacion nr.5(qyteti Pogradec)</i>		409,500	
<i>Fatura nr.117/2024, datë 03.09.2024+ situacion nr.6(qyteti Pogradec)</i>		393,750	

<i>Fatura nr.130/2024, datë 09.09.2024+ situacion nr.7(qyteti Pogradec)</i>		409,500	
<i>Fatura nr.143/2024, datë 24.10.2024+ situacion nr.8 (qyteti Pogradec)</i>		409,500	
<i>Fatura nr.149/2024, datë 04.11.2024+ situacion nr.9 (qyteti Pogradec)</i>		393,750	
<i>Fatura nr.164/2024, datë 02.12.2024+ situacion nr.10 (qyteti Pogradec)</i>		409,500	
<i>Fatura nr.7/2025, datë 15.01.2025+ situacion nr.11 (qyteti Pogradec)</i>		393,750	
<i>Fatura nr.18/2025, datë 12.02.2025+ situacion nr.12 (qyteti Pogradec)</i>		409,500	
Vërtetim nr.1048/3 prot., datë 08.08.2025 lëshuar nga Bashkia Pogradec, për realizimin me sukses të kontratës me object “Pastrim grumbullim dhe largim i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njërive administrative” nga Rej” SHPK për periudhën 01.01.2025 – 31.05.2025, shoqëruar me situacione mujore dhe faturat respective për këto situacione			
<i>Fatura nr.26/2025, datë 06.03.2025+ situacion nr.1 (qyteti Pogradec)</i>	Pastrim plazhi nga mbeturinat+Plug	393,750	
<i>Fatura nr.35/2025, datë 01.04.2025+ situacion nr.2 (qyteti Pogradec)</i>	im dhe lesim+pastrim bregu i liqinet	362,250	
<i>Fatura nr.45/2025, datë 02.05.2025+ situacion nr.3 (qyteti Pogradec)</i>	nga algat me me mjet special të posacëm i	409,500	

<i>Fatura nr.108/2025, datë 01.08.2025+ situacion nr.4 (qyteti Pogradec)</i>	pajisur me traktor tërheqës	393,750	
<i>Fatura nr.111/2025, datë 04.08.2025+ situacion nr.5 (qyteti Pogradec)</i>		409,500	
	Shumatore e faturave të pranuara	16,999,969	

Sa më sipër, nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik për kontratat e ngjashme të marra në shqyrtim rezulton, se ankimuesi 'Rej' SHPK me vlerën e përgjithshme prej 16,999,969 lekë pa TVSH të shërbimeve të ngjashme të realizuara sipas dokumenteve të paraqitura në sistemin e prokurimit elektronik e tejkalon vlerën prej 12,846,067 lekë pa TVSH që duhet të plotësojë ky operator ekonomik për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit. Sa më lart, nga verifikimi i shërbimeve të realizuara dhe dokumentacioni shoqëruar i tyre, të paraqitura si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik 'Rej' SHPK ka kryer vlerën e kërkuar të shërbimeve të ngjashme me zërat në preventivin të hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues 'Rej' SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 "Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ‘Rej’ SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

